



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:202447

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05466872

**PPP.nr.210/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, rr “Bulevardi Bill Clinton”, nr.5, kundër debitorit B.Q. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, me datë 18.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit B.Q., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.492/2022, i datës 12.09.2022, i lëshuar nga përmbareuesi privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.492/2022, i datës 12.09.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.492/2022, të datës 12.09.2022, përmbareuesi privat B.A., e ka caktuar përmbareimin e propozuar nga kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), kundër debitorit B.Q., për pagesën e shumës së borxhit prej 3,911.97 euro, në bazë të ekstraktit të librave afariste me numër DFE – ..., të datës 08.09.2022, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbaremore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbareuesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.492/2022, i datës 12.09.2022.

Gjykata, me qëllim të sqarimit të pretendimeve të debitorit në prapësim, me datë 14.03.2024, ka mbajtur seancën dëgjimore publike, në të cilën i autorizuari i kreditorit ka mbetur në tërësi në propozimin për përmbarim dhe në përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit. Po ashtu, ka shtuar se sa i përket parashkrimit që është thirrur debitori, këtë pretendim e kundërshtojmë si të pabazuar për shkak se debitori me pagesat e kohë pas kohëshme e ka bërë ndërprerjen e parashkrimit në kuptim të nenit 3687, par 1, të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar.

Po ashtu, i autorizuari i kreditorit ka shtuar se kreditori në propozimin për përmbarim ka precizuar saktë datat e shfrytëzimit të energjisë elektrike e që janë 13.02.2015 e deri më datë 31.08.2022, që përfshinë shfrytëzimin e rregullt të energjisë elektrike pa rikthimin e humbjeve.

Debitori, në seancën dëgjimore publike ka deklaruar se sa i përket shumës së borxhit të kërkuar nga kreditori, të njëjtën nuk e kundërshtoj sepse është borxh i akumuluar për shkak të shfrytëzimit të energjisë elektrike mirëpo sa i përket pagesës së këtij borxhi e njoftoj gjykatën se nuk kam mundësi financiare e as nuk kam mundësi të lidhi marrëveshje me kreditorin sepse nuk jam i sigurt se a do t'i përmbahem asaj marrëveshje. Po ashtu, theksoj se për çdo muaj faturat jam duke i paguar me rregull.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 27, par 1, të LPP-së, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse ekstrakti i verifikuar nga librat afariste DFE ..., i datës 08.09.2022, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri i atakuar me prapësim, është i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim të plotë me nenin 29, par 3, të LPP-së, sepse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se në bazë të dispozitave ligjore të LMD-së, kërkesat e tilla të përshkruara si në propozimin për përmbarim parashkruhen në afat prej një viti, ndërsa kreditori në propozimin për përmbarim ka kërkuar borxhin nga viti 2015, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar, sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit dhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 360, par 1, i LMD-së,

për arsye se në këtë rast është shkaktuar ndërprerja e afatit të parashkrimit nga neni 368, par 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është paraparë shprehimisht se : *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”* dhe me shikimin e shkresave të lëndës, gjegjësisht ekstraktit nga librat afariste të kreditorit, të datës 08.09.2022, pagesën nga debitori me datën 18.07.2022, për faturën ....., për shumën e borxhit prej 22.00 euro, e sidomos me deklarin e debitorit në seancën dëgjimore publike të mbajtur më datë 14.03.2024, në të cilën debitori ka deklaruar se e pranon në tërësi shumën e borxhit të kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarrim, ka konstatuar se debitori e ka pranuar borxhin që e ka ndaj kreditorit dhe si rezultat i këtij fakti nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit nga neni 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së. Për më tepër në nenin 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, është paraparë: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe në këtë rast duke e krahasuar datën e fundit të pagesës së shumës së borxhit prej 22.00 euro, e bërë më datë 18.07.2022 dhe datës kur kreditori e ka dorëzuar tek përmbarruesi privat propozimin për përmbarrim, siç është data 12.09.2022, nënkupton se nuk ka kaluar afati prej 1 viti i kërkuar në nenin 360, par 1, të LMD-së dhe kërkesa e kreditorit nuk është parashkruar (vjetërsuar).

Përveç tjerash, Gjykata, bazuar në propozimin për përmbarrim të kreditorit, periudhës kohore prej 13.02.2022 deri më datën 31.08.2022, për të cilën kreditori ka kërkuar shumën e borxhit prej 3,911.97 euro, llogaritjes së faturave për këtë periudhë kohore në bazë të ekstraktit të librave afariste, si dhe deklarin të autorizuarit të kreditorit në seancën dëgjimore publike, ka ardhur në përfundimin se shuma e borxhit prej 3,911.97 euro, e kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarrim, përputhet në tërësi me periudhën kohore të cekur më lart.

Gjithashtu, gjykata konstatoj se propozimi për përmbarrim i kreditorit është në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 38, par 1, të LPP-së, respektivisht propozimi për përmbarrim i kreditorit siç shihet e përmban kërkesën për përmbarrim, dokumentin e besueshëm, siç është ekstrakti i verifikuar nga librat afariste në origjinal, kërkesin e përmbarrimit dhe të dhënat e debitorit, duke e përfshirë edhe numrin personal të letërnjoftimit të debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.

Si përfundim, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim dhe në seancën dëgjimore publike, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit

dhe në seancën dëgjimore publike, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, Gjykata konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbaram P.nr.492/2022, i datës 12.09.2022, të mbetet në fuqi.

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.210/22, më datë 18.03.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.